



BASHKIA MIRDITË

Nr. 3671 Prot

Rrëshen.me 15/08.2017

KONTRATË
PËR
KOLAUDIM TË PUNIMEVE

OBJEKTI:

“Sistemim asfaltim i rrugës kryqëzimi autostradë – Rrëshen (faza I)”

KOLAUDATORI I PUNIMEVE

“DRICONS” Sh.p.k
Ing. Ndrec VOCI



INVESTITORI

BASHKIA MIRDITË
KRYETARI
Ndrec DEDAJ



“Sistemim asfaltim i rrugës kryqëzimi autostradë – Rrëshen (faza I)”

Ne zbatim të Udhezimit të Keshillit të Ministrave Nr. 3, datë 15.02.2001 me gjithë modifikimet e bera nga udhezimi i Keshillit të Ministrave Nr. 4, datë 17.05.2001 **“Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”**, lidhet kontrata midis Bashkise Mirditë perfaqesuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, Kryetari i Bashkise, **Ndrec DEDAJ**, i quajtur **“Investitori”** dhe Shoqerise **“DRICONS” Sh.p.k** me perfaqesues z. Ndrec VOCI, i quajtur Kolaudator i Punimeve me License _____ e vlefshme " Per supervizion + kolaudim ", leshuar nga M.P.P.T.T, nga Komisioni i dhenies se Liçensave Profesionale dhe NIPT **L52013020H**. Objekt i kesaj kontrate eshte Kolaudimi i punimeve te objektit:

“Sistemim asfaltim i rrugës kryqëzimi autostradë – Rrëshen (faza I)”

Kjo kontratë lidhet sot me datë ___/___/2017, pranë Bashkisë Mirditë ndërmjet palëve:

Bashkise Mirditë, me adresë: Sheshi“Abat Doçi“Rrëshen, përfaqësuar nga Kryetari I saj **Z.Ndrec DEDAJ**, këtej e ne vazhdim me cilësinë e Autoritetit Kontraktor(A.K.-investitori), dhe

Shoqerise “DRICONS” shpk., NIPT **L52013020H**, me adresë: TIRANE Njesia Bashkiake Nr.7, Rruja Adem Seit Kruja, Pallati ne Z,Kadastrale 8250

këtej e ne vazhdim me cilësinë e Kolaudatorit të Punimeve(Kolaudatori).

Baza ligjore: Neni 850 e vijues i Kodit Civil; Ligji Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me të gjitha ndryshimet, vlerësimi përfundimtar i prokurimit sipas faqes së APP-së.

Të dy palët bien dakort të nënshkruajnë kontratën me përmbajtje si më poshtë :

NENI 1
Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj kontrate është realizimi i shërbimit për Kolaudimin e Punimeve per objektin:

“Sistemim asfaltim i rrugës kryqëzimi autostradë – Rrëshen (faza I)”

NENI 2
Vlera e Kontratës

Vlera e kontratës është **129 914 (Njëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e katërmbëdhjetë) lekë pa tvsh.**

Vlera totale e kontratës është **155 897 (Njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë përfshire vlerën e tvsh.**

NENI 3

Të Drejtat, Detyrimet dhe Sanksionet e Kolaudatorit të Punimeve

Sipas ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të ndërtimit” dhe udhëzimeve në zbatim të tij.

NENI 4
Të Drejtat dhe Detyrimet e Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor ka detyrim të kryejë pagesën sipas kushteve të caktuara në këtë kontratë pas përfundimit të objektit dhe marrjes në dorëzim të tij.

NENI 5
Komunikimi

Komunikimi ndërmjet palëve kontraktuese do të jetë i vlefshëm vetëm kur bëhet me shkrim.

NENI 6
Procedurat e Pagesës

Pagesa do të bëhet në monedhën Shqiptare, me urdhër-xhirimi, brenda 30 ditëve nga dorëzimi i faturës tatimore, të sjellë nga Kontraktuesi në Zyren e Financës pranë A.K-së, mbas përpilimit të aktit të kolaudimit nga kolaudatori.

Likuidimi bëhet në llogarinë rrjedhëse të Kontraktuesit.Nr _____

NENI 7
Hyrja në Fuqi e Kontratës dhe Kohëzgjatja

Kjo kontratë hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të saj prej palëve dhe përfundon me datën e marrjes në dorëzim të objektit.

NENI 8
Mosmarrëveshjet Ndërmjet Palëve

Komunikimi ndërmjet palëve kontraktuese do të jetë i vlefshëm vetëm kur bëhet me shkrim.

Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen në mirëkuptim midis tyre.


Në rast se ky mirëkuptim nuk arrihet, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë Lezhe.

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe, në katër kopje me vlerë të barabartë secila, nga të cilat 1 (një) kopje për Kontraktuesin dhe 3 (tre) kopje për Autoritetin Kontraktor.

PALËT KONTRAKTUESE

KOLAUDATORI I PUNIMEVE

"DRICONS" Sh.p.k
Ing. Ndrec VOÇI



INVESTITORI

BASHKIA MIRDITË
KRYETARI
Ndrec DEDAJ

